KUVENDI
NR 1196 DATE 30.4.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr._____Prot.

Tiranë, më___.___.2020

Lënda: Propozim i projektligjit "Për disa ndryshime ne ligjin nr nr. 8550, datë 18.11.1999, 'Statusi i deputetit'"

Drejtuar: **Z. GRAMOZ RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Zoti Kryetar i Kuvendit!

Mbështetur në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, ju paraqes bashkëlidhur nismën legjislative "Për disa ndryshime ne ligjin nr nr. 8550, datë 18.11.1999, "Statusi i deputetit".

Ju uroj suksese në punën tuaj!

ERION PICIRI
DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT LIGJ

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8550, DATË 18.11.1999, "STATUSI I DEPUTETIT"

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPERISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 13 të ligjit 8550, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

"Paga bazë mujore bruto e deputetit nuk duhet të kalojë dyfishin e pagës mesatare mujore në nivel kombëtar dhe me gjithë komisionet, shpërblimet, dietat, transportin dhe telefonin nuk duhet te kalojë trefishin e pagës mesatare mujore në nivel kombëtar".

Neni 2

Në nenin 14, pika 2 ndryshohet si vijon:

*"Dieta e Kryetarit, zëvendëskryetarëve dhe deputetëve do të jenë jo m*ë shumë se *3 për qind të pagës bazë mujore. Tërësia e dietave të një muaji brenda vendit nuk mund të tejkalojnë 10% të pagës bazë mujore".*

Neni 3

Në nenin 16, pika 1 ndryshohet si vijon:

"Deputetit dhe bashkëshortes (bashkëshortit) të tij/saj u njihet e drejta e pajisjes me pasaportë

diplomatike gjatë kohës së kryerjes së mandatit, si dhe 6 muaj pas mbarimit të tij".

Neni 4

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Deputetët me edhe pa funksione parlamentare pajisen me shërbim telefonik. Vlefta e shpenzimeve për shërbimet e telekomunikacionit nuk duhet të kalojë 3% të pagës bazë".

Neni 6

Neni 20 ndryshohet si vijon:

1 Pika 1 e këtij neni riformulohet si vijon:
"Deputeti mbas mbarimit të mandatit përfiton të drejtën e shpërblimit për vjetërsinë sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
2 Pikat 2 dhe 3 të këtij neni shfuqizohen.

Neni 7

Neni 29 ndryshohet si vijon:

"Çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet".

Neni 8

Hyrja në fuqi

"Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare".

K R Y E T A R I
GRAMOZ RUÇI